

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

### KUALIFIKIMI PROFESIONAL "SIPËRMARRJE E AGJENCISË TURISTIKE"

#### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

|         |    |    |    |    |    |    |    |    |
|---------|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Kërkesa | 1  | 2  | 3  | 4  | 5  | 6  | 7  | 8  |
| Pikët   |    |    |    |    |    |    |    |    |
| Kërkesa | 9  | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 |
| Pikët   |    |    |    |    |    |    |    |    |
| Kërkesa | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 |
| Pikët   |    |    |    |    |    |    |    |    |
| Kërkesa | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 |    |    |
| Pikët   |    |    |    |    |    |    |    |    |

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Sipas ligjit të kërkesës nëse çmimi i portokalleve bie nga 80 lekë në 60 lekë atëherë: **1 pikë**
- A) Kërkesa për portokalle do të rritet;
  - B) Kërkesa për portokalle do të ulet;
  - C) Sasia e kërkuar për portokalle do të rritet;
  - D) Sasia e kërkuar për portokalle do të ulet;
2. Situata në të cilën ka shumë para për pak mallra konsiderohet si inflacion: **1 pikë**
- A) Galopant;
  - B) I moderuar;
  - C) Nga kërkesa;
  - D) Nga oferta ose kostoja;
3. Ndryshimi në sasinë e kërkuar të një malli ndodh atëherë kur: **1 pikë**
- A) Ndryshon çmimi i mallit;
  - B) Ulet kostoja e prodhimit të mallit;
  - C) Rriten të ardhurat e konsumatorit;
  - D) Përmirësohet teknologjia e prodhimit të mallit;
4. Kërkesa për faktorë prodhimi është: **1 pikë**
- A) Kërkesë e derivuar;
  - B) Gjithmonë konstante;
  - C) Kërkesë e drejtpërdrejtë;
  - D) E pavarur nga teknologjia e prodhimit;
5. Për të kuptuar termin turist janë të rëndësishme dy fakte. Cila nga alternativat e mëposhtme përmbush njërin prej tyre: **1 pikë**
- A) Të kërkuar një punë të përkohshme;
  - B) Të qëndrosh mbi një vit në vendin e vizituar;
  - C) Të ndërrosh përkohësisht vendbanimin;
  - D) Të ndërmarrësh një veprimtari që paguhet;
6. Ata që ofrojnë shërbime për turistët dalës në vendet e huaja janë operatorët turistikë dhe agjentët e udhëtimit që quhen: **1 pikë**
- A) Specialist;
  - B) Inbound;
  - C) Domestic;
  - D) Outbound;
7. Vizitat në qendrat historike apo muzeale nxiten nga motivet : **1 pikë**
- A) Njohëse;
  - B) Kurative;
  - C) Kulturore;
  - D) Familjare;

8. Një strukturë akomoduese që stimulohet nga toka, uji, deti, rëra e klima është një: **1 pikë**
- A) Motel;
  - B) Bujtinë;
  - C) Kamping;
  - D) Qendër kurative;
9. Ndërtesa që ofron shërbim akomodimi dhe parkimi, zakonisht me synimin për qëndrim të shkurtër të udhëtarëve, me vendndodhje në periferi të qendrave të banuara, pranë kryqëzimeve dhe rrugëve automobilistike është: **1 pikë**
- A) Motel;
  - B) Resort;
  - C) Bujtinë;
  - D) Fjetinë;
10. Ekskursioni është kombinim i organizuar i shërbimeve që përfshijnë të gjithë alternativat e mëposhtme përveç: **1 pikë**
- A) Ofrohen për shitje brenda të njëjtit çmim;
  - B) Ofrohen për një periudhë prej 48 orësh;
  - C) Ofrohen duke mos përfshirë akomodim gjatë natës;
  - D) Ofrohen për një periudhë më të shkurtër se 24 orë;
11. Që një "Agjenci turistike" të pajiset me licensë duhet të plotësojë disa kritere. Cila nga alternativat e mëposhtme **NUK** konsiderohet si kriter i plotësuar: **1 pikë**
- A) Të jetë rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimeve;
  - B) Personi ligjor mjafton të zotërojë një dëshmi kualifikimi profesional;
  - C) Personi ligjor të mos jetë një person i dënuar me vendim të formës së prerë;
  - D) Të zotërojë një mjedis pune jo më të vogël se 10 m<sup>2</sup> për ushtrimin e veprimtarisë;
12. Propozimi dhe hartimi i materialeve me karakter promociional, në përputhje me tendencat e tregut turistik, është detyrë kryesore e: **1 pikë**
- A) Agjencisë Kombëtare të Turizmit;
  - B) Ministrisë përgjegjëse për turizmin;
  - C) Degës territoriale të shërbimit të turizmit;
  - D) Komitetit Këshillimor të Sektorit Privat të Turizmit;
13. Në formimin e çmimit të produktit turistik ndikojnë faktorë kryesorë dhe faktorë shtesë Cila nga alternativat e mëposhtme është faktor kryesor: **1 pikë**
- A) Luhatjet midis sezoneve;
  - B) Kërkesa e gjeneruar nga klientët;
  - C) Strategjitë e çmimeve të konkurrentëve;
  - D) Kostot e rrjetit të shpërndarjes;

14. Të tregosh në mënyrë të detajuar çdo komponent të udhëtimit, mënyrën se si do të realizohet transporti, vendqëndrimet, shërbimet e pritjes, qëndrimin në hotel, aktivitetet e ndryshme ditore dhe gjithçka tjetër ka të bëjë me itinerarin: **1 pikë**
- A) Grafik;  
B) Linear;  
C) Analitik;  
D) Sintetik;
15. Sipas karakteristikave demografike tipologjia e turistit ka të bëjë me: **1 pikë**
- A) Klimën;  
B) Zakonet;  
C) Personalitetin;  
D) Profesionin;
16. Në lidhje me çmimin e një pakete udhëtimi, cila nga alternativat e mëposhtme është e duhura: **1 pikë**
- A) Nuk përfshin kostot e tërthorta të krijimit të një pakete;  
B) Është i njëjtit pavarësisht nga sezoni në të cilin kryhet udhëtimi;  
C) Ndryshon në varësi të madhësisë së grupit të udhëtarëve;  
D) Përfshin vetëm kostot e udhëtimit dhe fitimin e parashikuar;
17. Kosto e plotë për njësi e një pakete turistike është 40000 lekë dhe norma e parashikuar e fitimit 12%. Çmimi që synohet të arrihet është: **1 pikë**
- A) 30.000 lekë;  
B) 35.200 lekë;  
C) 40.000 lekë;  
D) 44.800 lekë;
18. Tri ortakë A, B, C vendosin krijimin e një agjencie turistike në 01/03/2018. Ortaku A derdh në agjenci 200,000 lekë në llogarinë rrjedhëse bankare, ortaku B derdh në agjenci vlerën 300,000 lekë të një ndërtese, ortaku C derdh në agjenci vlerën 500,000 lekë mallra për aredimin e saj. kapitali themeltar i kësaj agjencie do të jetë: **1 pikë**
- A) 200,000 lekë;  
B) 300,000 lekë;  
C) 500,000 lekë;  
D) 1,000,000 lekë;
19. Llogaritë e përdorura për evidentimin e kostove të paketave turistike: **1 pikë**
- A) Pasqyrojnë vetëm kostot fikse që i takojnë paketës turistike;  
B) Debitohen për të gjitha kostot që i takojnë paketës turistike;  
C) Përdoren për të pasqyruar vetëm kostot e tërthorta që i takojnë paketës përkatëse;  
D) Debitohen për kostot e drejtpërdrejta dhe kreditohen për kostot e tërthorta të paketës turistike;
20. Agjencia turistike "X" ka një kapital 1,200,000 lekë të investuar nga ortakët A, B, C, D në raportet 40%, 30%, 20%, 10%. Gjatë vitit 2022 agjencia turistike ka realizuar një fitim 200,000 lekë. Cila nga alternativat përfaqëson pjesën e fitimit që fiton ortaku A: **1 pikë**
- A) 20,000 lekë;  
B) 40,000 lekë;  
C) 60,000 lekë;  
D) 80,000 lekë;

21. Në secilin nga pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë. 4 pikë

- 1) Kosto totale është shuma e kostove për një nivel të caktuar prodhimi.  
PO      JO
- 2) Kosto fikse është ajo pjesë e kostos totale që nuk ndryshon me ndryshimin e nivelit të prodhimit brenda kufijve të kapacitetit.  
PO      JO
- 3) Kosto variabël është ajo pjesë e kostos totale që nuk ndryshon me ndryshimin e vëllimit të prodhimit.  
PO      JO
- 4) Kosto mesatare totale tregon se sa kushton mesatarisht çdo njësi prodhimi.  
PO      JO

22. Shpjegoni kërkesat e mëposhtme: 4 pikë

1) Çfarë është papunësia?

---

---

2) Çfarë kuptoni me Forcë Pune?

---

---

3) Çfarë kuptoni me termin "të punësuar"?

---

---

4) Si llogaritet norma e papunësisë?

---

---

23. Në secilin nga pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë. 4 pikë

- 1) "Shërbim turistik" është lehtësia që u ofrohet turistëve nga sipërmarrja turistike.  
PO      JO
- 2) "Veprimtari turistik" është tërësia e veprimtarive që zhvillohen në bazë të kërkesës dhe ofertës, në fushën e turizmit, dhe prodhon produkte karakteristike të turizmit.  
PO      JO
- 3) "Turizëm në hyrje" është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori rezident jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.  
PO      JO
- 4) "Turizëm në dalje" është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori jo rezident në territorin e Republikës së Shqipërisë.  
PO      JO

24. Lidhni me shigjetë anën e majtë me anën e djathtë: 4 pikë

Karakteristika sipas sjelljes konsumatore janë;

1) Motivimi

Karakteristika psikologjike janë;

2) Statusi

3) Zakonet

4) Personaliteti

25. Bazuar në qëllimin e udhëtimit, llojet e turizmit janë disa. Listoni më poshtë katër prej tyre:

4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

26. Një operator turistik do të llogarisë çmimin e katalogut për një paketë udhëtimi duke u bazuar në të dhënat e mëposhtme:

- 1) Kosto e plotë e paketës është 60.000 lekë
- 2) Norma e synuar e fitimit është 15% e kostos së plotë (9.000 lekë)
- 3) Nga çmimi i katalogut do të akordohen 8% komisione shitësve me pakicë të paketës së udhëtimit.
- 4) Nga çmimi i katalogut do të akordohen 4% ulje për pagesa me para në dorë.

**Kërkohet:**

- 1) Të llogaritet çmimi që synohet të realizohet
- 2) Të llogaritet çmimi i katalogut
- 3) Të llogaritet shuma e komisioneve që operatori do të përfshijë në çmim.
- 4) Të llogaritet shuma e uljeve të çmimeve që operatori duhet të përfshijë në çmim

1 pikë

1 pikë

1 pikë

1 pikë

|                                     |      |        |
|-------------------------------------|------|--------|
| Kosto e plotë                       |      | 60.000 |
| Fitimi                              | 15%  | 9.000  |
| Çmimi që synohet të realizohet      | 88%  |        |
| Çmimi i katalogut                   | 100% |        |
| Komisionet e shitjes me pakicë      | 8%   |        |
| Zbritjet për pagesa me para në dorë | 4    |        |

27. Gjatë muajit Maj 2023 një operator turistik ka kryer ndërmjet të tjerave dhe veprimet e mëposhtme:

- 1) Sipas vërtetimit bankar ka shitur një udhëtim turistik me vlerë 20.000 lekë sipas faturës Nr. 9, datë 8.05.2023 dhe po në të njëjtën datë është arkëtuar e gjithë vlera e udhëtimit;
- 2) Sipas vërtetimit bankar të datës 10.05.2023 ka arkëtuar 32.000 paradhënie për një udhëtim;
- 3) Sipas faturës Nr.5 Datë 15.05.2023 ka faturuar udhëtimin turistik për të cilin ka arkëtuar paradhënie për një vlerë prej 78.000 lekë;
- 4) Sipas vërtetimit bankar të datës 22.05.2023 ka arkëtuar nga klienti diferencën e mbetur të vlerës së udhëtimit të shitur (78.000 – 32.000 lekë)

(Për asnjërin prej veprimeve nuk do të llogaritet dhe regjistrohet TVSH)

**Kërkohe:**

- |  |               |
|--|---------------|
| 1) Të regjistrohet në ditar shitja e udhëtimit turistik                                | <b>1 pikë</b> |
| 2) Të regjistrohet në ditar paradhënia e arkëtuar nga klientët sipas vërtetimit bankar | <b>1 pikë</b> |
| 3) Të regjistrohet në ditar fatura e shitjes së udhëtimit turistik                     | <b>1 pikë</b> |
| 4) Të regjistrohet në ditar shlyerja e detyrimit nga klienti                           | <b>1 pikë</b> |

Ditari i përgjithshëm

| Data       | Përshkrimi i veprimit | Shuma debi | Shuma kredi |
|------------|-----------------------|------------|-------------|
| 8.05.2023  |                       |            |             |
| 10.05.2023 |                       |            |             |
| 15.05.2023 |                       |            |             |
| 22.05.2023 |                       |            |             |

28. Kur hartohet një itinerar udhëtimi, në zgjedhjen e rrugës më të përshtatshme mbahen parasysh disa kritere. Evidentoni më poshtë katër prej tyre: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

29. Për secilin nga konceptet e mëposhtme shpjegoni çfarë është:

4 pikë

1) "Agroturizëm"

---

---

2) "Fjetje dhe mëngjes (B&B)"

---

---

3) Turizëm rural

---

---

4) "Kamper"

---

---

30. Në secilin nga pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë.

4 pikë

1) Motivet kurative - janë ato të cilat lidhen me kalimin e periudhave ditore apo mujore në qendrat kurative të shëndetit.

PO JO

2) Motivet e peligrinazhit - janë motive që kanë të bëjnë me vizitimin e vendeve të shenjta, të objekteve të kultit, me frekuentimin e ceremonive të ndryshme fetare.

PO JO

3) Motivet njohëse - janë motive të cilat nxisin pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare.

PO JO

4) Itinerari sintetik - është ai itinerar i cili tregon momentet kyç të udhëtimit (oraret e nisjes, mbërritjes, vendqëndrimet etj.).

PO JO